

PAKETA E VETË-MARRJES PËR HPV


Kjo paketë përmban materialet e nevojshme për vetë-marrjen e mostrës.

Informacion i rëndësishëm


- Lexojini këto udhëzime me kujdes, në tërësinë e tyre, para se të filloni ta merrni mostrën.
- Në qoftë se i ndiqni udhëzimet, do të provoni vetëm një bezdë të vogël, por jo dhimbje.
- Marrja e mostrës nuk duhet kryer: gjatë menstruacioneve (periodave), gjatë shtatzënisë, në periudhën tremujore pas lindjes, po të keni pasur së fundi një operacion gjinekologjik ose në rast gjak-rrjedhjeje të pazakonshme ose dhimbjeje pelvike.
- Marrja e mostrës nuk duhet kryer po të keni përdorur ovula, kremra ose solucione larëse vaginale, kontraceptivë vaginalë ose preservativë 3 ditë të mëparshme.
- Marrja e mostrës nuk duhet kryer po të keni pasur marrëdhënie seksuale, skanime me ultratinguj ose ekzaminime gjinekologjike 2 ditë të mëparshme.
- Po të keni probleme, të mos ndiheni mirë/t'ju merren mendtë, bëni një pauzë ose këshillohuni me specialistin tuaj të kujdesit shëndetësor.
- Tamponi nuk përmban material me origjinë shtazore.

Përmbajtja e paketës së mostrës

Verifikoni që paketa i përmban të gjithë artikujt e listuar më poshtë. Mos filloni ta merrni mostrën, nëse ndonjë artikull mungon ose është i dëmtuar, por lidhuni me specialistin tuaj të shëndetit, për ndihmë.



Tamponi vaginal dhe tubi i marrjes



Qesja për kthimin e mostrës


Summary
First name
Date of birth
Sample date
Sample Vaginal Self-Swab

Etiketa e mostrës

UDHËZIME PËR PACIENTIN – MOSTRA PËR TAMPON

- 1** Lani duart me sapun dhe ujë të ngrohtë. Hapeni paketën që përmban tamponin dhe tubin e marrjes.
Hiqani tapën tubit të marrjes dhe lëreni diku aty afër.

- 2** Ka rëndësi që të mbani ekuilibrin pa vështirësi, gjatë marrjes së mostrës. Mund ta merrni mostrën duke qëndruar në këmbë.
Rrotullojeni tapën e tubit të tamponit për ta hequr vullën mblyllëse, para se të merrni mostrën.




- 3** Nxirrni tamponin nga tubi dhe mbajeni me gishtat e shenjta e kuqe në mes, për ta marrë mostrën. **Mos e mbani nga tapa e kuqe në fund.**
Mos lejoni që maja e bardhë e tamponit të prekë ndonjë sipërfaqe, gjatë marrjes së mostrës. Në qoftë se ndodh që tamponi të prekë aksidentalisht një sipërfaqe, kërkonti një paketë të re.



- 4** Mbajeni tamponin drejt, kur e futni ose kur e nxirrni nga vagina. Me dorën tjetër, tërhiqeni lehtë lëkurën jashtë vaginës. Futni majën e tamponit te hapja e vaginës. Drejtojeni majën e tamponit për nga fundi i shpinës dhe relaksoni muskujt.

- 5** Futni tamponin në vaginë, sikurse tregohet. Në qoftë se tamponi nuk rrëshqet lehtë, rrotullojeni nga pak, kur po e futni. Gishtat që mbani te vija e kuqe do t'ju pengojnë që ta shtyni më tutje se ç'duhet. Nëse nuk arrini ta futni, mos u përpiqni me forcë.




- 6** Rrotullojeni tamponin për 10-30 sekonda, duke u siguruar që ai po prek muret e vaginës, pastaj hiqeni tamponin me kujdes.




- 7** Vendoseni me kujdes tamponin në tubin e marrjes.

Duke e mbajtur tubin të palëvizur, këputeni shufrën te vija e kuqe. Hidhni pjesën e këputur të tamponit, duke lënë në vend skajin me pambuk.



- 8** Vidhoseni tapën në tubin e mbledhjes dhe shtrëngojni fort.



Tani jeni gati që t'ia dorëzoni tamponin specialistes suaj të shëndetit. Ajo do ta kompletojë procedurën e nevojshme për mostrën para se kjo të dërgohet për testim. Jepini specialistes së shëndetit tubin e mbledhjes me mostrën, qesen transparente të mostrës, etiketën e mostrës dhe këtë fletë informative me udhëzime.



Për t'i parë këto udhëzime në gjuhë të tjera, vizitoni:
www.hslpathology.com/cervical-screening-self-collection

© The Doctors Laboratory Limited, 2025.
Ilustrimet: © Jag Matharu/Thin Air Productions
TAP5692B-ALBANIAN/30-07-25/VB